




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.398/2021

Datë: 30 nëntor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.25, nenit 24 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 33 dhe 34 i Rregullores Nr. 03/2021 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve, në mbledhjen 272-të, të mbajtur më datë 30 nëntor 2021, merr këtë:


V E N D I M

- I. Znj. Valentina Sopjani, gjyqtare me mandat fillestar në Gjykatën Themelore Prishtinë, propozohet tek Presidentja e Republikës së Kosovës, për riemërim me mandat të përhershëm.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 30 nëntor 2021.

A r s y e t i m

Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve më datë 19 nëntor 2021, i ka rekomanduar Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të vendos mbi propozimin për riemërimin e gjyqtarës Valentina Sopjani, me mandat të përhershëm, mandati fillestar i të cilës përfundon më 21 janar 2022.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 30 nëntor 2021, pas shqyrtimit të rekomandimit të Komisionit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, në bazë të nenit 24 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, vendosi që gjyqtarja Valentina Sopjani, të propozohet tek Presidentja e Republikës së Kosovës, për riemërim me mandat të përhershëm.



Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës;
- Znj. Valentina Sopjani, gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë;
- Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.